

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 16.2.2016**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË “EVN TRADING” SHPK, PËR HEQJEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 179 SERIA T12, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 124, DATË 29.8.2012, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të neneve 39, pika 1, dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 5.1 (g) të licencës për tregtim T12, nenit 5, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike për heqjen e licencës së shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 179, seria T12, miratuar me vendimin nr. 124, datë 29.8.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s

konstatoi se:

- Shoqëria “EVN Trading” sh.p.k., me shkresën nr. 28, prot., datë 6.1.2016, ka paraqitur në ERE një kërkesë për heqjen e licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 179, seri T12, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124, datë 29.8.2012.

- Kërkesa e shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., është e mbështetur në legjislacionin në fuqi, neni 5, paragrafi i parë, i rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 179 dhe numër serial T12, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 124, datë 29.8.2012, për aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë personat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**